



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 60 Akti

Nr. 67 Vendimi

Tiranë më 05.10.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari
Brunilda Bekteshi
Suela Zhegu

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në Tiranë, më datë 3 tetor 2018, ora 09:30, në zyrat e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ahmet S. Jangulli, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, i paraqitur personalisht, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5, dhe neni Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, komisioneren Brunilda Bekteshi, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Ahmet Selim Jangulli, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, me funksion gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Në bazë të pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës, duke qenë se z. Ahmet Jangulli ka kandiduar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit menjëherë, duke u shortuar më datë 15 janar 2018, me trup gjykues nr. 3, të përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Komisionere;
Suela Zhegu	Komisionere;
Brunilda Bekteshi	Relatore.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.01.2018 u caktua kryesuese znj. Valbona Sanxhaktari. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. John Leonardo.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe 3) Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi i subjektit nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli.*”

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas

¹ILDKPKI-ja, me shkresën nr. ***prot., datë 12.01.2018, ka depozituar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar shoqëruar me dosjen përkatëse të përbërë nga 554 (pesëqind e pesëdhjetë e katër) faqe, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

²DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., 02.11.2017, shkresën nr. *** shtesë dhe shkresën nr. *** prot., shtesë, datë 15.11.2017, ka dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet nuk duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, u gjetën elemente dyshuese mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u gjetën indice dhe elemente që ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.”.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes më datë 13.09.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 07.06.2018, subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike për përbërjen e trupit gjykues, si dhe u njoftua se ka të drejtë të deklarojë konfliktin e interesit me anëtarët e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se në dijeninë e tij nuk ishte në konflikt interesi me asnjë prej komisionerëve.

Më datë 14.09.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës për të dhënë shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

Më datë 24.09.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e tij së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.

Më datë 25.09.2018, trupi gjykues nr. 3, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 03.10.2018, ora 09:30, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Më datë 03.10.2018 u zhvillua seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ku ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Pasi trupi gjykues dëgjoi qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procesin e rivlerësimit, ndërpreu seancën dëgjimore për ta rifilluar më datë 05.10.2018, ora 10:00, për shpalljen e vendimit.

Më datë 05.10.2018, trupi gjykues e deklaroi të mbyllur seancën dëgjimore dhe shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

³KLD-ja, me shkresën nr. ***, datë 27.02.2018, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Ahmet Jangulli ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, në drejtim të respektimit të afateve të përcaktuara, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me aftësitë e komunikimit, Komisioni i rezultoi se, në komunikimet e vazhdueshme që ka pasur me subjektin, ka konstatuar se subjekti nuk ka një komunikim në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, duke e bërë shpeshherë të vështirë të kuptohet qartë argumentimi që ka përdorur. Trupi gjykues konkludon se subjekti demonstroi aftësi të papranueshme në komunikim, sipas parashikimeve të nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Për subjektin e rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, me funksion gjyqtar, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatorja e çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, për pasuritë e deklaruara, si më poshtë:

Tokë bujqësore (*pemëtore, arë truall dhe ndërtesë*), ndarë në 8 parcela, në fshatin ***, Njësia Administrative ***, Bulqizë, fituar me ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën”, me sipërfaqe 2.281 m².

Apartament, me sipërfaqe 67 m², në lagjen “***”, Bulqizë (*sipas kontratës, 107.668 lekë*).

Makinë “Mercedes - Benz”, me targë ***, që vjen si rezultat i shkëmbimit me makinën që subjekti ka pasur më parë, të bërë nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.11.2005. Pjesa takuese: 100 %.

Gjendje cash: 1.296.645 lekë.

Huadhënie personave të tretë në shumën 12.000.000 lekë

Nga hetimi i thelluar, Komisioni krijoi dyshime dhe, për rrjedhojë, i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me asetet e mëposhtme:

1. **Makinë**⁴ “Mercedes-Benz”, me targë ***, që vinte si rezultat i shkëmbimit me makinën që subjekti kishte pasur më parë, sipas kontratës së shitblerjes të datës 07.11.2005, zotëruar 100 %.

ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e kësaj pasurie është shprehur: “*Është i dyshimtë fakti i shkëmbimit në vitin 2012 i një automjeti, prodhim i vitit 1995 (i përdorur nga subjekti që nga viti 2005) me një automjet, prodhim i vitit 2003 (i përdorur nga shkëmbyesi që nga viti 2011)*”.

1.1. Nga hetimi administrativ i Komisionit për këtë pasuri, ka rezultuar se:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (referuar si “**DPSHTRR**”⁵) me shkresën me nr. ***, datë 12.02.2018, informon se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar automjetin me targë ***, ndërsa automjetin me targë *** (në kohën kur e ka përdorur subjekti, targa e automjetit ka qenë ***), nga data 04.09.2006 deri më datë 27.12.2012 dhe automjetin me targë ***, nga data 07.09.2012 deri më datë 23.10.2017.

DPSHTRR-ja, me shkresën nr. ***, prot., datë 21.02.2018, ka sjellë fotokopje të njësuar të dosjeve të automjeteve me targa ***, ***dhe ***.

1.1.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së DPSHTRR-së u konstatua se:

Subjekti i rivlerësimit kishte pasur në pronësi automjetin “Mercedes-Benz”, me targë ***, me vit prodhimi 1995, i blerë në vitin 2005 dhe i deklaruar me vlerë 570.000 lekë, bashkë me shpenzimet e doganës (vlera në kontratë 300.000 lekë, mjet i pazhdoganuar). Me kontratën e shkëmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.09.2012, këtë automjet e shkëmben me z. S. M në datën 05.09.2012, me një mjet të cilin S. M e ka blerë më 22.12.2011, në vlerën 100.000 lekë, nga R. M. Ky i fundit e kishte blerë këtë automjet më 17.12.2011, në Itali, në vlerën 7.040 euro. Bashkë me tarifata doganore, vlera e automjetit shkon 1.172.482 lekë.

Nisur nga vlera e këtij automjeti, që bashkë me doganën shkonte në **1.172.482 lekë**, krijohen dyshime për shkëmbimin e bërë me një automjet, i cili kishte vlerë më pak se gjysma e makinës që kishte pasur subjekti.

Nga shkëmbimi rezulton se subjekti i rivlerësimit bëhej pronar i automjetit me targa ***, “Mercedes-Benz”, E 270CDI, vit prodhimi 2003, regjistruar në DPRTSH Dibër në vitin 2011 dhe S. M bëhej pronar i automjetit me targa ***, “Benz” C250D, vit prodhimi 1995, regjistruar në DPSHTRR Tiranë në datën 04.09.2006. Në lidhje me targën ***, targa e automjetit ishte ***. Në datën 05.09.2012, subjekti shkëmben automjetin e tij me automjetin e S. M dhe targa bëhet ***, i cili ia shet në vitin 2016, shtetasit A. N dhe targa bëhet ***.

Lidhur me dyshimet e krijuara, trupi gjykues i kërkoi shpjegime subjektit, i cili në deklaratimet e dhëna më datë 04.08.2018, ndër të tjera, shpjegoi se:

“S. M, personin që kishte shkëmbyer automjetin e kishte mik nëpërmjet shokut tim të familjes (G. T), ku ky i fundit ka vajzën e tij për bashkëshorte. Makina që kishte shkëmbyer ka pasur opsione të viteve të mëvonshme se viti i saj i prodhimit, kishte qenë gati në tako (e papërdorur), pasi është përdorur vetëm për nevoja familjare (brenda qytetit ku kam banuar), ka qenë e mbajtur mirë dhe e paraqitshme (ka pasur sy), duke u kujdesur për të deri te targa (e mbajtur

⁴ Subjekti i bashkëlidh praktikës aneks nr. 4/3, si dhe shkresë nr. *** prot., datë 25.0.12017, të degës doganore Bllatë. Dërgimi i praktikës doganore, ***, datë 17.12.2011, mban bashkëlidhur:

- Kontratë shkëmbimi nr. *** rep., nr. ***kol., datë 05.09.2012, ndërmjet Ahmet Jangullit dhe S. M për shkëmbimin e automjeteve të tyre. Ahmet Jangulli bëhet pronar i automjetit me targa ***, “Mercedes-Benz”, E 270CDI, viti i prodhimit 2003, regjistruar në DPRTSH Dibër në vitin 2011 dhe S. M bëhet pronar i automjetit me targa ***, “Benz”, C250D, viti i prodhimit 1995, regjistruar në DPRTSH Tiranë në datën 04.09.2006.

- Kontratë shiteje nr. *** rep., nr. *** kol., 22.12.2011, me shitës R. M dhe blerës S. M, çmimi 100.000 lekë.

- Dokumente italiane blerjeje, hyrjeje dhe zhdoganimi, viti 2011, për mjetin në pronësi të R. M.

⁵ Shih në dosje shkresën e Komisionit me nr. *** prot., datë 02.02.2018, drejtuar DPSHTRR-së, dhe i është kërkuar informacion mbi çdo automjet të regjistruar në emër të subjektit apo personit të lidhur me të.

për qejf). Mikut tim (z. M.) i kishte bërë djali aksident në Itali, me makinën që kam shkëmbyer, dhe pas aksidentit u ishte bërë fiksim, për të mos e mbajtur më makinën në shtëpi, por me e nxjerrë në shitje sa t' u jepnin në të.”

Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni, u konstatua se subjekti nuk kishte burime të mjaftueshme për blerjen e automjetit, shtimin e likuiditeteve dhe shpenzimeve të kryera në vitin 2005.

Tabela e analizës financiare/Viti 2005.

	Përshkrimi	2005
1	TË ARDHURA	1.280.515
	Të ardhura nga pagat e subjektit të rivlerësimit	1.012.755
	Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	267.76
2	SHPENZIME	803.571
	Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI-së	803.571
3	PASURI	700.948
	Automjet tip “Benz”	570
	Kursime të vitit	130.948
	DIFERENCA PËR SHPENZIME TË TJERA (1-2-3)	-224.004

Në përfundim të hetimit, nga analiza e fakteve dhe ajo financiare rezultojnë dyshime të arsyeshme në lidhje me shkëmbimin e automjeteve (pasi ai duket joproporcional, pa asnjë kompensim nga ana e subjektit), si dhe mungesë e burimeve të mjaftueshme financiare për të blerë automjetin në vitin 2005.

1.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Mbi konstatimet e Komisionit, në shpjegimet e tij të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera⁶, subjekti ka parashtruar si më poshtë:

Në lidhje me analizën financiare të realizuar nga Komisioni, si dhe me konstatimin se subjekti ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për blerjen e automjetit në vitin 2005: “Në deklaratimet e mia për vitin 2005, nuk ka të shtuara likuiditete dhe si e tillë shuma 130.948 lekë, e llogaritur nga Komisioni, nuk qëndron (nga 224.004 lekë – 130,948 lekë = 93.056 lekë). Pra, thjesht e vetëm duke hequr kursimet e vitit 2005, që janë futur gabimisht në analizën financiare, dhe duke marrë edhe ato shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së, diferenca në shpenzime shkon në 93.056 lekë.

Shpenzimet e jetesës nuk mund të merrreshin sipas shpenzimeve të jetesës që trajton ILDKPKI-ja (si një mesatare që ato trajtojnë...). Sipas të dhënave të mësipërme, shpenzimet e jetesës për vitin 2005 mbeten në shumën 713.614 lekë dhe jo në shumën 803.571 lekë që trajton ILDKPKI-ja”.

1.3. Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk ka likuiditete të shtuara gjatë vitit, Komisionit i ka rezultuar se në deklaratën periodike të këtij viti, subjekti nuk deklaroi kursime. Komisioni konstatoi shtim të likuiditeteve në bankë në shumën 130.948 lekë, të cilat i përfshiu në kursime të vitit. Pas pretendimit të subjektit, se gjendja në total e likuiditeteve nuk ka ndryshuar, vlera e kursimeve të vitit bëhet 0 lek.

Sa i përket pretendimit të subjektit se shpenzimet e jetesës nuk janë në shumën që trajton ILDKPKI-ja, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron pasi përlllogaritjet e ILDKPKI-së për shpenzimet e jetesës janë mbi bazën e të dhënave të INSTAT-it. Gjithashtu, nga

⁶ Shih parashtrimet e subjektit në dosje të datës 24.09.2018.

vlerësimi tërësor i përlogaritjeve, çmon se duhet të mbahet në konsideratë dhe numri prej 5 anëtarësh të familjes, sikurse ka qenë subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues, pas vlerësimit të pretendimit të subjektit, çmon se subjekti gjendet në situatën e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën **93.056 lekë**⁷ për blerjen e automjetit, por edhe për shpenzimet e kryera gjatë këtij viti, si dhe vlerëson se veprimi i shkëmbimit të makinës mbetet i dyshimtë, pasi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk e bindën trupin gjykues për të kundërtën e rezultateve të hetimit.

2. Huadhënie

Subjekti, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar shuma të dhëna peronave të tjerë të lidhur, huadhënie – përdorim, në vlerën 12.000.000 lekë, si vijon:

a) Shumën 8.000.000⁸ lekë, të ardhura të krijuara ndër vite, dhënë në përdorim pa interes ndër vite z. E. T, sipas vërtetimit-nënshkrimit nr. *** rep., datë 25.01.2017 (*E. M. T – shok, mik*);

b) Shumën 2.000.000⁹ lekë, të ardhura të krijuara ndër vite, dhënë në përdorim pa interes ndër vite z. A. R, sipas deklaratës nr. *** rep., datë 24.01.2017 (*A. H. R – shok, mik*);

c) Shumën 2.000.000¹⁰ lekë, të ardhura të krijuara ndër vite, dhënë në përdorim pa interes ndër vite z. A. T, sipas deklaratës nr. *** rep., datë 26.01.2017 (*A. Xh. T –shok, mik*).

ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë për burimin e këtyre likuiditeteve, është shprehur “*Fshehje dhe deklarim i rremë në lidhje me huadhëniet në shumën totale prej 12.000.000 lekësh në deklaratat e interesave private në ILDKPKI (në vitet respektive të dhënies së huave nga subjekti deklarues), si dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar, pasi subjekti ka deklaruar qarkullim nga veprimtaria ‘Noteri’ e bashkëshortes dhe jo fitim. Mbi këtë bazë, ka deklaruar gjendjen e kursyer cash*”.

2.1. Nga hetimi administrativ, Komisioni ka konstatuar se:

Huadhëniet e deklaruara nga subjekti janë kryer në rrugë informale dhe jo nëpërmjet sistemit bankar. Gjithashtu, rezulton se në deklaratimet noteriale të përpiluara për procesin e rivlerësimit kalimtar (*në janar 2017*), nuk është përcaktuar arsyeja e marrjes/dhënies së huas. Për këto huadhënie ka disa deklarata noteriale ku deklarohet se huat në shumat 8.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë janë marrë në vitin 2014, ndërsa shuma 2.000.000 lekë para disa vitesh.

Në lidhje me huadhëniet e sipërcituara, u krye analiza financiare për të vlerësuar nëse subjekti ka pasur mundësi për të krijuar këto likuiditete, që më pas i ka dhënë hua, duke u bazuar në të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes, sipas dokumentacionit të institucioneve shtetërore dhe atij të depozituar nga vetë subjekti.

Qendra Kombëtare e Biznesit (referuar si “**QKB**”)¹¹, me shkresën nr. *** prot., datë 22.02.2018, informon se shtetasja M. J figuron e regjistruar si person fizik me aktivitet “Noteri” me NUIS ***, me status “Aktiv”.

⁷ Sipas rezultateve të hetimit, shuma e pajustificuar ishte - 224,004 lekë, pas pranimit të pretendimit të subjektit, se gjendja në bankë në shumën 130.948 lekë nuk është kursim i vitit, shuma e pajustificuar bëhet 93.056 lekë (224.004 – 130.948).

⁸ Për këtë shumë, subjekti ka paraqitur (aneks nr. 4/6 + 4/7):

Deklaratë të datës 25.01.2017, nga E. T dhe vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 25.01.2017;

Deklaratë të datës 27.01.2017, me lëndë “Në lidhje me deklarimin e pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit si subjekt i rivlerësimit”.

⁹ Për këtë shumë, subjekti ka paraqitur (aneks nr. 4/6 + 4/7): Deklaratë të datës 24.01.2017, nga A. R dhe vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 24.01.2017, dhe kartë ID; Deklaratë të datës 27.01.2017, me lëndë “Në lidhje me deklarimin e pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit si subjekt i rivlerësimit”.

¹⁰ Për këtë shumë, subjekti ka paraqitur (aneks nr. 4/6 + 4/7):

Deklaratë të datës 26.01.2017, nga A. T dhe vërtetim nënshkrimi nr. ***rep., datë 26.01.2017, dhe kartë ID;

Deklaratë të datës 27.01.2017, me lëndë “Në lidhje me deklarimin e pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit si subjekt i rivlerësimit”.

¹¹ Shih në dosje shkresën e Komisionit nr. *** prot., datë 02.02.2018, drejtuar QKB-së, me të cilën i është kërkuar informacion në lidhje me ndonjë aktivitet tregtar të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër (referuar si “DRT”)¹², me shkresën nr. ***prot., datë 22.02.2018, informon se tatimpaguesja M. J, person fizik, pajisur me NUIS ***, është e regjistruar në DRT Dibër. Nga kontrolli në sistemin C@TS rezulton se subjekti nuk ka detyrime tatimore të palikuiduara. Subjekti ka deklaruar dhe paguar kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për të llogaritur të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, analiza financiare është bazuar në shkresën e DRT-së Dibër, me nr. ***, datë 07.07.2017, drejtuar ILDKPKI-së, në të cilën janë pasqyruar qarkullimi dhe fitimi për vitet përkatëse për aktivitetin tregtar “Noteri”, të personit të lidhur.

Analiza financiare sipas tabelës vijuese

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultuan mospërputhje në lidhje me fitimin nga aktiviteti privat “Noteri” i bashkëshortes në deklaratat e interesave private periodike ndër vite në ILDKPKI, pasi shumat e deklaruara nuk përputheshin me rezultatin financiar të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër.

Nga përlllogaritjet u konstatua se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për shtimin e likuiditeteve, shpenzimet e kryera dhe pasurinë e blerë në vitet 200 - 2012, në vlerën 7.800.744 lekë, për pasojë rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kursimet e krijuar, të cilat i deklaroi në deklaratën “Vetting”.

Përshkrimi		2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
1	TË ARDHURA	1.280.515	1.323.532	1.407.236	1.948.152	2.313.927	2.131.922	1.355.511	1.537.120
	Të ardhura nga pagat e subjektit	1.012.755	995.233	956.830	792.664	1.067.976	1.088.856	1.199.927	1.228.621
	Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	267.760	177.930						168.500
	Të ardhura nga biznesi bashkëshortja		150.369	450.406	1.155.488	1.245.951	1.043.066	155.584	139.999
2	SHPENZIME	803.571	856.239	803.571	803.571	803.571	803.571	991.75	803.571
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	803.571	803.571	803.571	803.571	803.571	803.571	803.571	803.571
	Shpenzime udhëtimi							164.577	0
	Shpenzim tatimi rivlerësim pasurie							23.602	0
	Paguar këst kredie apartamenti		52.668						
3	PASURI	700.948	1.382.088	3.395.700	3.699.868	1.568.187	1.360.977	645.441	1.676.034
	Automjet tip "Benz"	570.000							
	Kursime të vitit	130.948	1.382.088	3.395.700	3.699.868	1.568.187	1.360.977	645.441	1.676.034
	DIFERENCA PËR SHPENZIME TË TJERA (1-2-3)	-224.004	-914.796	-2.792.035	-2.555.287	-57.831	-32.626	-281.68	-942.485

Total në vlerën 7.800.744 lekë

2.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe me rezultatet e hetimit të Komisionit, në shpjegimet e tij, të paraqitura pas kalimit të barrës së provës, si dhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera, ka parashtruar se:

Në lidhje me deklarin e të ardhurave dhe fitimin e realizuar nga aktiviteti privat “Noteri” i bashkëshortes: *“Për vitet 2006, 2007 dhe 2008, në deklaratime periodike pranë ILDKPKI-së ka pasur parregullsi, gjë të cilën e kam sistemuar me deklaratimet përkatëse që kam bërë në vitin 2009, dhe gjë të cilën e kam ridekluar po në vitin 2014 para ILDKPKI-së (gjatë hetimit administrativ të kryer, për një rikontrroll të plotë, dhe pa na vënë në dijeni për rikontrrollin e plotë).*

Sipas pretendimeve të subjektit, në vitet 2006, 2007 dhe 2008, në vend të deklarimit të fitimit neto nga aktiviteti, ai ka deklaruar qarkullimin vjetor, si dhe në vend të deklaronte shtesat e likuiditeteve, ai ka deklaruar në deklaratat periodike gjendjet e tyre (*likuiditeteve*), duke i paraqitur si shtesa. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se nga ana e Komisionit, në analizën

¹² Shih në dosje shkresën e Komisionit nr. *** prot., datë 02.02.2018, me të cilën është kërkuar informacion në lidhje me situatën tatimore (të ardhura, shpenzime, etj.) për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

financiare të realizuar, nuk janë përfshirë paga e bashkëshortes, të cilën ajo e ka marrë për disa vite.

Subjekti, në shpjegimet e datës 24.09.2018, ka depozituar gjithashtu dhe dokumente të tjera për të provuar fitimin neto nga aktiviteti privat i bashkëshortes. Këto dokumente u referohen deklaratave që ka bërë subjekti për aktivitetin tregtar të bashkëshortes (*xhiron dhe fitimin vjetor*), sipas vetë deklaratave të depozituara në Bashkinë e Dibrës, për vitet 2006, 2007 dhe 2008. Sipas formularëve të paraqitur nga subjekti si provë, pretendohet se për vitin 2007, fitimi neto i aktivitetit të bashkëshortes ka qenë më i lartë nga ai i paraqitur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër. Subjekti ka pretenduar se informacioni i pasqyruar në shkresën e Drejtorisë Tatimore Rajonale Dibër, nr. ***, datë 07.07.2017, drejtuar ILDKPKI-së, mbi të cilin Komisioni ka realizuar llogaritjet, nuk pasqyron situatën reale mbi xhiron vjetore dhe fitimin e vitit 2007. Subjekti, në shpjegimet përfundimtare të sjella në datën 02.10.2018, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke argumentuar se deklaratimet periodike të viteve 2006, 2007 dhe 2008 kanë pasur parregullsi, të cilat janë sistemuar prej tij në vitin 2009, nëpërmjet deklaratave dhe sqarimit që i ka bërë situatës pranë institucionit të ILDKPKI-së.

2.3. Arsyetimi ligjor dhe vlerësimi provave

Trupi gjykues, pas analizimit të deklaratave periodike të plotësuara nga subjekti dhe depozituar në ILDKPKI, provat e siguruar gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, vlerëson se:

a) Lidhur me pretendimin e fitimit neto nga aktiviteti i bashkëshortes si notere

Trupi gjykues, gjatë vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, ka konstatuar se dokumenti që subjekti ka depozituar pranë Komisionit, për të provuar fitimin më të lartë nga aktiviteti i noterisë për vitin 2007, me përshkrimin “Deklarata e qarkullimit vjetor për vitin 2007”, shoqëruar me të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2007, depozituar pranë Bashkisë Peshkopi, është i ndryshëm dhe pasqyron një fitim më të madh sesa i njëjti dokument (*deklarata e qarkullimit vjetor të biznesit të bashkëshortes për vitin 2007*), dorëzuar pranë Drejtorisë së Tatimeve dhe depozituar nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së. Pra, rezultuan dy dokumente të njëjta për vitin 2007 të plotësuara nga subjekti, që pasqyrojnë fitime të ndryshme për të njëjtin vit.

Deklarata e qarkullimit vjetor për vitin 2007, depozituar në ILDKPKI, ka elementet e dokumentit zyrtar, vulën e institucionit të tatimeve dhe numër protokolli, që tregon se është sigluar nga institucioni i Tatimeve Dibër. Deklarata e depozituar pranë Komisionit ka një fitim tre herë më të lartë (*përkatësisht fitimi 1.725.575 lekë*) sesa fitimi i pasqyruar në dokumentin që është depozituar pranë ILDKPKI-së (*përkatësisht fitimi 450.406 lekë*). Fitimi dhe xhiroja e aktivitetit të biznesit të bashkëshortes së subjektit, pasqyruar në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, është i njëjtë me ato të pasqyruara në formularin e vitit 2007 që subjekti ka depozituar pranë ILDKPKI-së (*përkatësisht fitimi 450.406 lekë*), mbi bazën e të cilave Komisioni bëri përllogaritjet financiare.

Trupi gjykues vlerëson se deklarata e qarkullimit vjetor për vitin 2007, që ka paraqitur subjekti pas kalimit të barrës së provës, për të njëjtin vit të të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes, nuk pasqyron të dhëna reale të fitimit për të cilat të jenë paguar tatimet përkatëse, pasi bien në kundërshtim me vetëdeklarimet për aktivitetin “Noteri” pranë Drejtorisë së Tatimeve. Deklarata e re e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk e bindi trupin gjykues, i cili në vlerësimin e dy deklaratave të paraqitura, pranoi si më të saktë atë të paraqitur nga ILDKPKI-ja.

b) Në lidhje me pretendimin e subjektit, se ka pasur pasaktësi në deklaratimet e viteve 2006, 2007 dhe 2008, lidhur me deklaratimet e gjendjes së likuiditeteve *cash* dhe se këto pasaktësi i ka

sistemuar në vitin 2009, - sipas procesverbalit të ILDKPKI-së, - trupi gjykues i vlerësoi ato si veprime fiktive, pasi subjekti duket se ka bërë deklarin e likuiditeteve në varësi të asaj që ka paraqitur si fitim të biznesit.

Në deklarinet periodike (viti 2006, 2007, 2008), subjekti deklaroi gjendje likuiditeti më të lartë, që ka rrjedhur nga deklarimi i pasaktë i qarkullimit të biznesit të bashkëshortes si fitim neto.

Subjekti i rivlerësimit mban një procesverbal në ILDKPKI në datën 06.04.2009, si dhe një në deklaratat sqaruese të datës 10.04.2009, por nuk rezultoi i korrigjuar dhe as saktësuar deklarimi për ato vite.

Për sa arsyetohet më sipër dhe në vlerësim të provave të administruara, trupi gjykues në përfundim çmon se deklarimet e bëra nga ana e subjektit në procesverbalin e datës 06.04.2009 dhe në deklaratat e datës 10.04.2009, nuk mund të merren në konsideratë, pasi:

- ato janë kontradiktore ndërmjet tyre, duke mos provuar me ndonjë dokument se cila është e vërteta;
- duken si përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të rregulluar situatën financiare pas evidentimit të diferencave të pambuluara nga ana e ILDKPKI-së.
- as në deklarimet periodike vjetore përkatëse nuk është mundur të provohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur *cash* vlerën e deklaruar dhe se e ka pakësuar atë nëpërmjet dhënies së huas.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer veprime fiktive, duke deklaruar gjendje likuiditetesh të cilat pretendon më vonë se janë gabim dhe duke i ndryshuar, pasi nuk arrinte të justifikonte ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara. Shpjegimet e subjektit, se pasaktësitë në deklarime kanë qenë të paqëllimshme, nuk e bindën trupin gjykues për të kundërtën e rezultateve të hetimit.

c) Lidhur me pretendimin e subjektit se gjatë analizës financiare të kryer nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë pagat e bashkëshortes për vitet 2009 - 2011, kurse për vitet 2012 - 2016, dhe 2013 - 2016, pretendohet se në të ardhurat e dokumentuara është trajtuar gabim paga e bashkëshortes, trupi gjykues arsyeton se:

Komisioni, në analizën financiare ka marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga pagat e bashkëshortes, për ato periudha të cilat provohen me dokumentacion si të konfirmuar nga institucionet përkatëse, ashtu dhe nga ato të paraqitura nga vetë subjekti gjatë të gjitha fazave të procesit të rivlerësimit të tij.

Komisioni konstaton se në dosjen e hetimit administrativ nuk i rezultoi që institucionet përkatëse të konfirmojnë të ardhura nga paga për bashkëshorten, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi ndonjë provë të re/dokument nga sigurimet shoqërore, ku të provohej marrja e pagës nga ana e bashkëshortes së tij për vitet që pretendohet se gabimisht nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

d) Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, gjendja e bankave në fund të çdo viti i është shtuar gjendjes së likuiditeteve të deklaruara nga subjekti. Pas sqarimit të subjektit të se gjendja në banka është e përfshirë në totalin e kursimeve, trupi gjykues e merr në konsideratë pretendimin e tij.

Tabela pasqyruese e ndryshimit të likuiditeteve.

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Totali I likuiditeteve para	530.948	1.913.036	5.308.736	9.008.604	10.576.791	11.937.768	12.583.209	14.259.242
Totali I likuiditeteve pas	400.000	1.800.000	5.300.000	9.000.000	10.556.688	11.928.195	12.454.228	13.090.768
Diferenca	130.948	113.036	8.736	8.604	20.103	9.573	128.981	1.168.475

Me rilogaritjet, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, situata financiare pasqyron se subjekti i rivlerësimit vazhdon të ketë pamjaftueshmëri në vlerën 6.672.993 lekë.

Në konkluzion, për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se:

- Subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për shtimin e likuiditeteve në vitet 2005 – 2012 në shumën 6.672.993 lekë, për pasojë rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kursimet e krijuara, të cilat i deklaroi në deklaratën “Vetting” si të dhëna hua.
- Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe ato ndër vite, shumat e dhëna hua, sipas deklaratave të huamarrësve.
- Rezultoi deklarim i rremë i fitimit të aktivitetit të bashkëshortes për vitin 2007, si burim i deklaruar për krijimin e likuiditeteve.

3. Kredia në bankën “Societe Generale Albania”

3.1. Gjatë hetimit ka rezultuar se banka “Societe Generale Albania” sh.a.¹³, me shkresën nr. ***, datë 15.02.2018, informon se personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kredi me këste standarde bashkëmërore me shtetasen M. V, në monedhën lek, sipas kontratës së datës 28.10.2014, në shumën 700.000 lekë. Kjo kredi rezultonte me status të palikuiduar¹⁴ në datën 31.01.2017, pjesa e principalit të mbetur për t’u likuiduar ka qenë 436.750 lekë.

Nga verifikimi i deklaratave periodike nga viti 2014 deri në deklaratën “Vetting”, Komisionit i rezultoi se personi i lidhur nuk i ka deklaruar detyrimet financiare ndaj personave juridikë/banka “Societe Generale Albania” sh.a., e për pasojë i kaloi barrën e provës subjektit.

3.2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Lidhur me mosdeklarimin e kredisë me këste standarde bashkëmërore, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se është vënë në dijeni për këtë kredi në momentin që ishte njohur me rezultatin e hetimit. Sipas tij, në dijeninë e bashkëshortes bëhet fjalë për një dorëzani dhe jo si kredi marrëse për llogari të saj apo bashkëkredi marrëse, dhe duke e trajtuar veprimin juridik si një veprim që lidhet vetëm me sigurimin e kreditorit për ekzekutimin e detyrimit, nuk është trajtuar si detyrim prej bashkëshortes. Duke mos qenë para detyrimeve financiare, por para sigurimit të kreditorit për ekzekutimin e detyrimit, nuk është trajtuar si detyrim prej bashkëshortes në deklaratat e interesave private periodike ndër vite, etj.

3.3. Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, Komisioni e gjen të arsyeshëm pretendimin e subjektit se personi i lidhur mund të jetë futur realisht në këtë marrëdhënie kontraktore me bankën për të garantuar shlyerjen e një kredie. Por, sikurse rezultoi nga kontrata e kredisë bankare nr. ***, datë 28.10.2014, bashkëshortja e subjektit është në kontratë në cilësinë e bashkëdebitores dhe jo të dorëzanesës. Pavarësisht kësaj, duke qenë në cilësinë e bashkëkreditores formalisht (*sipas pretendimeve të subjektit*), trupi gjykues çmon se subjekti duhet ta kishte deklaruar këtë kredi, sepse *de jure* personi i lidhur figuron debitore e bankës “Societe Generale Albania” sh.a., për pasojë e çmon atë si deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me këtë kredi

¹³ Shih në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 05.02.2018, drejtuar 27 bankave dhe institucioneve bankare, me të cilën është kërkuar informacion bankar për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

¹⁴ Refero shkresën nr. ***, datë 15.02.2018.

Në përfundim, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “**DSIK**”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës të deklasifikuar pjesërisht¹⁵, për subjektin e rivlerësimit, ku informon se nga institucionet verifikuese raportohet se:

- *Për subjektin e rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, disponohen të dhëna në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprimtari korruptive, në disa procese gjyqësore, gjatë kohës kur ushtronte detyrën si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe, më vonë, si gjyqtar pranë Gjykatës Administrative Shkodër”.*
- *Për z. Ahmet Jangulli, me detyrë kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë (në atë kohë) ka të dhëna për raste të korrupsionit pasiv pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, ku në bashkëpunim me një prokuror dyshohen se kanë favorizuar disa të pandehur në dhënien e vendimeve kundrejt mitës”.*

DSIK-ja vijon në raportin e saj se, në konfirmim të konstatimit për papërshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit z. Ahmet Jangulli, gjykojmë të merren parasysh elementet që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive, pasi në frymën kundër korrupsionit të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.

Nga institucionet verifikuese, DSIK-ja ka konstatuar se:

“Ahmet Jangulli, kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në bashkëpunim me një prokuror disa vite përpara periudhës së rivlerësimit, dyshohet se kanë favorizuar të pandehurit në dhënien e tri vendimeve:

- i. kanë marrë një shumë parash për një çështje penale;*
- ii. kanë favorizuar një punonjës të gjendjes civile, akuzuar për falsifikim të dokumenteve të gjendjes civile;*
- iii. kanë favorizuar dy të pandehur në një proces gjyqësor.*

Në vlerësim të të dhënave për subjektin e rivlerësimit, Grupi i Punës ka konfirmuar konstatimin për papërshtatshmërinë për ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

1. Hetimi i Komisionit

Në lidhje me rastet korruptive të raportuara nga institucionet ligjzbatuese sipas pikës 1 sipërcituar, Komisioni ka kryer verifikimet dhe ka kërkuar dosjet gjyqësore përkatëse për të cilat kishte raportime për raste korruptive. Nga dokumentacioni gjyqësor rezultoi se çështja e vetme e gjykuar prej tij, i referohet dosjes gjyqësore me nr. ***, datë 12.07.2004, ndaj shtetasve Sh. L., M. S. e K. A., akuzuar për veprën penale “Përdorim i pasaportave të falsifikuara dhe

¹⁵ Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së, nr. *** prot., datë 01.08.2018.

shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 189/116 dhe 24817 të Kodit Penal. Kjo akuzë është saktësuar nga prokurori i çështjes, nga kualifikimi i veprës sipas nenit 189/2 të Kodit Penal, në nenin 189/1 dhe 25 të Kodit Penal.

Komisioni, gjatë verifikimit të dosjes penale, konstatoi se:

a) Nga shqyrtimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore për këtë dosje, vihet re se procesverbali i seancës 4 ka në përmbajtje “.....pyetet prokurori nëse ka akte të tjera të hetimit paraprak që nuk janë përfshirë në fashikullin e gjykimit dhe prokurori konfirmon se ka disa akte të tilla”. Në seancën e 5-të, prokurori ka deklaruar se: “Nuk ka akte të tjera të hetimit paraprak, pasi të gjitha aktet janë përfshirë në fashikullin e gjykimit”, ndonëse në seancën e mëparshme ishte deklaruar e kundërta.

b) Për këtë çështje, prokurori kishte kërkuar për secilin nga të pandehurit dënim me 2 (dy)¹⁸ vjet burgim, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit kishte vendosur: për një të pandehur dënimin e tij me periudhën e paraburgimit, për një të pandehur dënimin e tij si fajtor, duke e dënuar me gjobë në vlerën 200.000 lekë, dhe për të pandehurin tjetër shpalljen të pafajshëm.

Prokurori i çështjes, për dy shtetasit e akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve apo vizave”, ka kërkuar dënimin e tyre me 2 (dy) vjet burgim dhe për të akuzuarin e tretë, për shpërdorim detyre, dënimin e tij me 1 (një) vit burg.

Ndërkohë që, në vendimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka çmuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për të akuzuarit me iniciale SH. L., M. S., nga neni 189/1 “Falsifikimi i letërnjoftimeve apo vizave” në nenin 186/1 të Kodit Penal për veprën penale “Përdorim të dokumenteve të falsifikuara”.

Në përfundim, gjyqtari ka vendosur për shtetasin Sh. L. dënimin e tij me kohën e paraburgimit, shtetasin me iniciale M. S. e ka shpallur të pafajshëm dhe shtetasin K.A., të akuzuar për shpërdorim detyre, e ka deklaruar fajtor, duke e dënuar me një gjobë në masën 200 mijë lekë.

2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet mbi kriterin e figurës

Pas kalimit të barrës së provës, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur mbi konstatimet e kryera në raportin e dërguar nga institucioni i Drejtorisë së Informacionit të Klasifikuar, kurse mbi hetimin e dosjes gjyqësore nga ana e Komisionit, ndër të tjera, shpjegon se: “.... Kërkesa ndaj prokurorit qenka bërë në kuadrin e kërkesave paraprake dhe konkretisht kërkesës së të pandehurit me iniciale Sh. L. dhe të (...) për gjykim të shkurtuar, dhe gjykata para se të shprehej ndaj kërkesës së të pandehurit Sh. L. dhe të (...) për gjykim të shkurtuar, paska pyetur prokurorin për aktet që rrinë në fashikullin e tij (proceduralisht jo të gjitha aktet futen në fashikullin e gjykimit dhe gjykata, para se të shprehet ndaj kërkesës për gjykim të shkurtuar, duhet të vlerësojë të gjitha aktet, **pasi dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore, VGJL nr. *** datë 29.1.2003 ...**). Në seancën e radhës, siç duket, prokurori mund të jetë konsultuar me fashikullin e tij dhe me fashikullin e gjykimit, dhe do të ketë rezultuar se në fashikullin e tij nuk do të ketë pas akte të tjera të hetimit paraprak, që nuk kanë qenë përfshirë në fashikullin e gjykimit (në praktikën gjyqësore rëndom i fusin të gjitha aktet në fashikullin e gjykimit. Për vendimin e mësipërm të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit me vendimin penal nr. ***, datë 17.6.2005, paska vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë

¹⁶ Neni 189 “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013):

“Falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave apo i vizave të falsifikuara dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”

¹⁷ Neni 248 “Shpërdorimi i detyrës” (Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013):

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.”

¹⁸ Masa e dënimit për veprën penale të falsifikimit dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet ndërsa për veprën penale të shpërdorimit të detyrës masa ndëshkimore është burgim deri në shtatë vjet.

08.11.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë, për dy të pandehurit, prishjen e vendimit të mësipërm dhe pushimin e çështjes penale... për veprën penale 'Shpërdorim detyre' (punonjësi i gjendjes civile)".

3. Nga analizimi i të gjitha elementeve të cituara më sipër, si dhe shqyrtimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti lidhur me kriterin e figurës, trupi gjykues çmon se:

Standardet e kontrollit të figurës (neni 38 i ligjit nr. 84/2016) zhvillohen bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme. Kontrolli i figurës zhvillohet në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, armiqësor dhe miqësor, të cilat mund të favorizojnë ose disfavorizojnë subjektin e rivlerësimit. Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 të këtij neni dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni.

Referuar nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, kjo procedurë kryhet nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në bashkëpunim me Grupin e Punës, i cili ka verifikuar nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar, dhe në rastin konkret ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

Referuar raportit të DSIK-së, trupi gjykues ka vërejtur se informacioni për veprimet korruptive të subjektit rezultojnë në një shtrirje kohore të gjatë.

Por, pavarësisht sa disponohet në këtë raport, trupi gjykues çmon se informacioni i dhënë nga DSIK-ja gjen mbështetje edhe nga hetimi administrativ mbi dosjen për veprime korruptive në bashkëpunim me një prokuror, siç janë rrethanat e ndryshimit të kualifikimit të veprës penale për të akuzuarit.

Ky vlerësim dhe qëndrim vlen për aq kohë sa Komisioni, gjatë zhvillimit të hetimeve të tij dhe nëpërmjet dokumentacionit të administruar nuk ka konstatuar fakte ndryshe, si dhe përderisa shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk e kanë bindur trupin gjykues.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe bazuar edhe në raportin e DSIK-së, duhet aplikuar pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Vlerësimi i aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, është kryer nga Komisioni bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- kriteret parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; dhe
- denoncimet e paraqitura nga publiku.

Raporti mbi vlerësimin profesional është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Raporti është bazuar në analizimin e të dhënave të rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti i KLD-së është bazuar në: Formularin e vetëdeklarimit, një dokument ligjor të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Nga ky institucion, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, në raportin profesional të kryer është konstatuar se:

a) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit, Ahmet Jangulli, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 4 dokumente, një “Vendim gjyqësor”, një “Bisedime përfundimtare” të paditësit Ahmet Jangulli në gjykim civil, një “Ankim civil administrativ” të gjyqtarit Ahmet Jangulli kundër projektaktit të vlerësimit profesional të tij të viteve 2007 - 2009 dhe një raport-analizë e punës së gjyqtarit Ahmet Jangulli, trajtim juridik i tij për vitin 2015.

KLD-ja ka konstatuar se vendimi i vetëm gjyqësor i përzgjedhur dhe i paraqitur i përket Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër të vitit 2014, ndërsa tri dokumentet e tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk përmbushin kriterin e “dokumentit ligjor” të parashikuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, ndaj si të tilla nuk janë marrë në analizë.

Problematikat e konstatuara nga KLD-ja, në këtë vendim:

- i. Vendimi nr. ***, datë 03.04.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, që i përket paditësit N. H kundër të paditurit Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Shkodër dhe INUV Shkodër, si dhe ndërhyrësit dytësorë Q. S, me objekt “Sigurimin e padisë dhe shfuqizimin e akteve administrative nr. ***, datë 02.10.2013 e nr. ***, datë 13.12.2013”. Në këtë çështje gjyqtari Ahmet Jangulli ka qenë gjyqtar i vetëm dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.
- ii. Ky vendim është shkarkuar në rrugë elektronike dhe nuk i janë bashkëngjitur akte, që të tregojnë nëse është ushtruar ose jo ankim kundër tij.
- iii. Dosja civile administrative është regjistruar në datën 26.12.2013 dhe gjykimi ka përfunduar në datën 03.04.2014, pas 3 muajsh e 8 ditësh. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin standard një mujor të përcaktuar nga germa “c” e pikës 5 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit¹⁹.
- iv. Vendimi është strukturuar në paragrafë dhe në pjesë, të ndarë me tituj të emërtuar dhe të numërtuar. Konstatohet se në përgjithësi janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë ndonjëherë paraqiten të gjata, por përmbajnë referenca ligjore. Teksti në disa raste paraqitet jo i qartë dhe i kuptueshëm.

Në përshkrimin e 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar si vijon:

1. Dokumenti nr. 1, çështja civile nr. *** regj., datë 22.01.2014, që i përket paditësit Prefektura e Qarkut Shkodër, kundër të paditurit S. Gj. B, me objekt “Shfuqizimin e pjeshëm të aktit të marrjes së tokës së fshatit ***, komuna Bushat, në emër të S. Gj. B etj., përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.05.2014.

¹⁹Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.04.2010, të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”

Konstatimet e KLD-së për këtë dosje:

- i. **Nuk pasqyrohet veprimi procedural që ka kryer gjyqtari për të kaluar nga seanca përgatitore e datës 24.01.2014 në atë të datës 28.04.2014, që tregon se ka kaluar një periudhë 3-mujore pa veprime të dokumentuara.** Po kështu, megjithëse në seancën përgatitore të datës 07.05.2014 gjyqtari ka lënë 3 ditë afat për ndreqjen e të metave të padisë, seanca është çelur në datën 21.05.2014, pas 14 ditëve. Janë caktuar tri seanca përgatitore, me distancë rreth 1 muaj e gjysmë nga njëra-tjetra. Ndër tri seancat e zhvilluara, dy kanë qenë joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së palës së paditur në seancë, për të cilin nuk konfirmohet marrja dijani. Ndër tri seancat e zhvilluara, dy prej tyre janë çelur me orarin e përcaktuar më parë nga gjyqtari, ndërsa për njërin nga seancat, respektimi i orarit nuk mund të analizohet, pasi gjyqtari nuk ka dokumentuar orën në të cilën kjo seancë ishte planifikuar të çelej.
 - ii. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar përgjithësisht është i rregullt, por ka edhe disa të meta. Në dosje gjenden tri vendime për caktimin e seancës përgatitore. Të tri procesverbalet e seancës përgatitore, të administruara në dosje, janë të paplota, pasi mungojnë disa nga të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, siç janë gjeneralitetet e të paditurit dhe pasqyrimi i shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ndërgjyqëse. Të tria procesverbalet e administruara në dosje rezultojnë të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa vendimet e ndërmjetme të nxjerra nga gjyqtari me akt të veçantë janë të panënshkruara prej tij dhe një prej tyre ka edhe pasaktësi në datë.
2. Dokumenti nr. 2, çështja gjyqësore nr. *** regj., datë 08.06.2016, që i përket kërkuarit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, dega Shkodër, me objekt “Lëshim urdhri ekzekutimi”, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.06.2016.

Konstatimet e KLD-së për këtë dosje:

- i. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në datën 08.06.2016. Me shortin elektronik të zhvilluar në datën 08.06.2014, çështja i është caktuar për gjykim z. Ahmet Jangulli. Me urdhrin “Për caktimin e seancës gjyqësore”, të datës 13.06.2016, gjyqtari Ahmet Jangulli e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore më 29.06.2016, në orën 10:00, duke urdhëruar njoftimin e kërkuarit. Ky urdher është i panënshkruar nga gjyqtari.
- ii. Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Ahmet Jangulli në sekretari në datën 30.07.2014 - **pas 1 muaji e 1 dite nga shpallja, tej afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.**
- iii. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka zgjatur **21 ditë**, në intervalin kohor 08.06.2016 - 29.06.2016. **Kjo kohëzgjatje është tej afatit 5-ditor të caktuar nga neni 511, germa “ç” e Kodit të Procedurës Civile.** Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.
- iv. Gjyqtari nuk ka marrë masat për menaxhimin e çështjes, për të caktuar seancën gjyqësore brenda afatit **5-ditor të parashikuar në nenin 511 “Urdhri i ekzekutimit” të Kodit të Procedurës Civile. Seanca për lëshimin e urdhrin është caktuar pas 21 ditëve.** Është caktuar vetëm 1 seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, ku gjyqtari, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit.
- v. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti përgjithësisht janë të sakta nga ana formale. Urdhri i gjyqtarit për caktimi e seancës gjyqësore është i panënshkruar.
- vi. Në vendimin përfundimtar, fjalitë ndonjëherë paraqiten të gjata, por përmbajnë shumë referenca ligjore. Teksti në ndonjë paragraf paraqitet i pakuptueshëm.

3. Dokumenti nr. 3, çështja gjyqësore nr. *** regj., datë 29.01.2014, që i përket paditësit B. K kundër të paditurit DRSSH Shkodër, me objekt “Shfuqizimin e vendimit të KQA nr. ***, datë 22.11.2013, vendimit të KRA nr. *** datë 24.09.2013 dhe vendimit nr. ***, datë 28.08.2013 të Degës së Përfitimeve Shkodër, si dhe detyrimin për pension pleqërie”, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.06.2014.

Konstatimet e KLD-së për këtë dokument:

- i. Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Ahmet Jangulli në sekretari në datën 27.06.2014 - **pas një dite** nga shpallja, brenda afatit 7-ditor të përcaktuar nga neni 42, pika 3, i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
 - ii. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka zgjatur gjithsej **4 muaj e 28 ditë, në intervalin kohor 29.01.2014 - 26.06.2014. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 1-mujor të caktuar nga pika 5, germa “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në tejkalimin e afatit ka ndikuar mosorganizimi i mirë i punës nga ana e gjyqtarit, i cili ka zhvilluar seancën e dytë përgatitore pas 4 muajsh nga seanca e parë.** Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.
 - iii. Gjyqtari ka caktuar seancën e parë përgatitore brenda afatit 7-ditor të parashikuar në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012, por nuk ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes. Një nga veprimet e para përgatitore, siç është ai i kthimit për plotësim të të metave të padisë, është kryer nga gjyqtari pas 4 muajsh, në shkelje të nenit 25/1 të ligjit nr. 49/2012, ku parashikohen afate të shpejta e të arsyeshme, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë. Edhe periudha 4-mujore për t’i njoftuar të paditurit padinë dhe aktet shoqëruese të saj është në shkelje të afatit 10-ditor nga marrja e njoftimit, e parashikuar në nenin 25/1/b të ligjit nr. 49/2012.
 - iv. Lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në disa raste ato nuk rezultojnë të pasqyruara saktë. Kështu, nuk pasqyrohet veprimi procedural që ka kryer gjyqtari për të kaluar nga seanca përgatitore e datës 31.01.2014 në atë të datës 09.06.2014. Po kështu, megjithëse në seancën përgatitore të datës 09.06.2014 gjyqtari ka lënë tri ditë afat për ndreqjen e të metave të padisë, seanca gjyqësore është çelur në datën 25.06.2014, pas 16 ditëve. Janë caktuar dy seanca përgatitore dhe dy seanca gjyqësore, me distancë rreth 1 muaj e gjysmë nga njëra-tjetra. Një seancë nuk ka qenë produktive (seanca 2), pasi gjyqtari duhet t’i kishte konstatuar të metat e padisë që në seancën e parë. Të katër seancat e zhvilluara janë çelur me orarin e përcaktuar më parë nga gjyqtari.
 - v. Në dosje gjenden dy vendime për caktimin e seancës përgatitore, të cilat nuk janë të nënshkruara nga gjyqtari. Dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike, në referencë të rregullave procedurale civile, pasi janë administruar më parë diskutimet përfundimtare të palëve e më pas procesverbalet përgatitore e gjyqësore, duke e bërë të vështirë shfrytëzimin e dosjes për palët. Aktet në dosje janë të inventarizuara rregullisht.
 - vi. Në vendimin përfundimtar, teksti përgjithësisht paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, por ndonjë paragraf nuk gjen lidhje me çështjen në gjykim.
4. Dokumenti nr. 4, çështja gjyqësore nr. ***regj., datë 31.07.2014, që i përket paditësit E. I kundër të paditurës Prefektura e Qarkut Kukës, me objekt “Konstatimin e zgjidhjes së kontratës së punës, me efekt të menjëhershëm e pa shkaqe të justifikuara, dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës etj.”, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.09.2015.

Konstatimet e KLD-së për këtë dosje:

- i. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka zgjatur gjithsej **1 vit e 2 muaj**, në intervalin kohor 31.07.2014 - 30.09.2015. **Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 6-mujor** për çështjet civile me palë kundërshtare (*ku përfshihen edhe mosmarrëveshjet e punës*) të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në tejkalimin e afatit ka ndikuar mosorganizimi i mirë i punës nga ana e gjyqtarit, i cili ka lënë pa veprime çështjen një vit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.
 - ii. Gjyqtari nuk ka marrë masat për menaxhimin e çështjes, pasi ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë për plotësimin e të metave në datën 01.09.2016, **një vit pas seancës së parë përgatitore, ndërkohë që në nenin 25 “Veprimet përgatitore” të ligjit nr. 49/2012, në pikën 1, germa “a”, parashikohet se brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë** veprimi i parë që kryen gjyqtari është që i kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat deri në 10 ditë.
 - iii. Veprimet procedurale të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në disa raste nuk rezultojnë të pasqyruara saktë. Nuk pasqyrohet veprimi procedural që ka kryer gjyqtari për të kaluar nga seanca përgatitore e datës 01.09.2014 në atë të datës 01.09.2015. Po kështu, megjithëse në seancën përgatitore të datës 01.09.2015 gjyqtari ka **lënë 10 ditë afat për ndreqjen e të metave të padisë, seanca gjyqësore është çelur në datën 29.09.2015, pas 28 ditëve**. Janë caktuar dy seanca përgatitore dhe dy seanca gjyqësore, me distancë mbi 4 muaj nga njëra-tjetra. Ndër katër seancat e zhvilluara, dy seancat përgatitore kanë qenë joproductive, për shkak se nuk janë njoftuar nga gjykata **palët ndërgjyqëse dhe veprimet janë të përcipta, pa asnjë rezultat për çështjen**.
 - iv. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt. Por, të gjitha vendimet e gjyqtarit të vetëm, të administruara në dosje, nuk janë të nënshkruara nga gjyqtari, por me “d.v.”. Gjithashtu konstatohet se në dosje gjenden dy vendime për caktimin e seancës përgatitore.
 - v. Dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike, në referencë të rregullave procedurale civile, pasi janë administruar më parë bisedimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse e më pas procesverbalet e seancave përgatitore e ato gjyqësore, duke u bërë dosja jo lehtësisht e shfrytëzueshme për palët.
5. Çështja gjyqësore nr. *** regj., datë 16.12.2015, që i përket paditësit E. A kundër të paditurve Drejtoria e Policisë së Shtetit Tiranë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 04.12.2015, për shqyrtimin e masës disiplinore ulje në gradë 6 muaj, rikthimin e gradës komisar dhe trajtimeve financiare në gjendjen e mëparshme”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 13.06.2016.

Konstatimet e KLD-së për këtë dosje:

- i. Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Ahmet Jangulli në sekretari në datën 15.06.2014 - **pas 2 ditëve nga shpallja**, brenda afatit procedural të parashikuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
- ii. Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka zgjatur gjithsej **5 muaj e 28 ditë**, në intervalin kohor 16.12.2015 - 13.06.2016. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 1-mujor të caktuar nga pika 5, germa “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në tejkalimin e afatit ka ndikuar mosorganizimi i mirë i punës nga ana e gjyqtarit, i cili ka zhvilluar seancën e dytë përgatitore pas 4 muajsh nga seanca e parë, duke kthyer aktet për plotësimin e të metave. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i

rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

- iii. Gjyqtari ka kërkuar kthimin e padisë dhe të akteve për plotësim e të metave të padisë **pas 4 muajsh, në shkelje të nenit 25/1 të ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet për afate të shpejta e të arsyeshme, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë.**

Nuk pasqyrohet veprimi procedural që ka kryer gjyqtari për të kaluar nga seanca përgatitore e datës 15.04.2016 në urdhrin “Për caktimin e seancës gjyqësore”, të datës 29.04.2016.

Janë caktuar 11 seanca (3 përgatitore dhe 8 gjyqësore), me distancë rreth 20 ditë nga njëra-tjetra. Nga njëmbëdhjetë seancat e zhvilluara, nëntë prej tyre kanë qenë produktive, ndërsa dy seanca kanë qenë joproduktive. Në një nga procesverbalet e dosjes, atë të seancës gjyqësore të datës 08.06.2016, nuk është pasqyruar në procesverbal prania ose jo e paditësit.

- iv. Dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike, në referencë të rregullave procedurale civile, pasi janë administruar më parë diskutimet përfundimtare të palëve e më pas procesverbalet përgatitore e ato gjyqësore, duke e bërë të vështirë shfrytëzimin e dosjes për palët.
- v. Në vendimin përfundimtar, fjalitë ndonjëherë paraqiten të gjata, por përmbajnë edhe shumë referenca ligjore. Teksti përgjithësisht paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, por ndonjë paragraf nuk gjen lidhje me çështjen në gjykim.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, më datë 26.03.1994. Më datë 01.07.1994, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe më datë 12.04.1995, kryetar i po kësaj gjykate, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 24.10.2008 kur është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Që prej datës 04.11.2013 ushtron funksionin e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i protokollit të ripunuara në datën 19.02.2018, rezulton se gjatë periudhës së rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Ahmet Jangulli janë paraqitur gjithsej 16 ankesa në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (6 ankesa në vitin 2014, 7 ankesa në vitin 2015, dhe 1 ankesë në vitin 2016).

6 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar pa u verifikuar: 2 ankesa (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndërsa 4 ankesa të tjera (2 të vitit 2014 dhe 2 të vitit 2015) janë arkivuar si ankesa të përsëritura.

10 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- i. një ankesë e vitit 2014 është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe për shkelje etike. Në përfundim, gjyqtarit i është tërhequr vëmendja me shkrim për mënyrën e komunikimit jo etik, ndërsa pretendimi për mosrespektim formal të ligjit u verifikua në vijim derisa Gjykata e Lartë u shpreh se vendimi i dhënë nga gjyqtari Ahmet Jangulli ishte i drejtë. Për pasojë, u konkludua se pretendimi për mosrespektim formal të ligjit ishte i pabazuar dhe ankesa për këtë pretendim është sugjeruar të arkivohet;
- ii. një ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe gjyqtarit i është tërhequr vëmendja me shkrim për shkak të zvarritjes së gjykimit të një çështjeje të vitit 2014, si dhe është sugjeruar verifikimi në vijim për një çështje të dytë të vitit 2014;
- iii. një ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje në gjykim dhe është konstatuar se gjyqtari Ahmet Jangulli ka shqyrtuar çështjen gjyqësore nr. *** regj., datë 14.01.2014, për 6 muaj dhe në përfundim ka shpallur moskompetencën. Inspektorati ka vlerësuar se ka pasaktësi në kryerjen e veprimeve procedurale, që ka ndikuar në zvarritjen e

- gjykimit, por duke mbajtur në konsideratë ngarkesën tepër të lartë të gjyqtarit është sugjeruar regjistrimi i ankesës për vlerësim profesional dhe etik;
- iv. një ankesë e vitit 2015, bazuar në raportimin e kryetares së gjykatës, është verifikuar për shkak të cenimit të vendimit nr. ***, datë 27.02.2014, të dhënë nga gjyqtari Ahmet Jangulli, në shkelje të vendimit të unifikuar nr. ***, datë 06.12.2013, të Gjykatës së Lartë. Në përfundim është konkluduar që kjo ankesë t'i regjistrohet atij për vlerësim profesional, pasi vendimi unifikues në ditën e dhënies së vendimit nga gjyqtari Ahmet Jangulli nuk ishte botuar ende në fletoren zyrtare;
 - v. një ankesë e vitit 2015 është verifikuar për zvarritje në gjykimin e çështjes administrative nr. *** regjistrimi, datë 29.05.2014, dhe është konstatuar se gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit, 1 muaj e 16 ditë. Duke marrë në konsideratë ngarkesën tepër të lartë sasiore të gjyqtarit, kjo ankesë i është regjistruar atij për vlerësim profesional dhe etik;
 - vi. një ankesë e vitit 2015 është verifikuar për zvarritje në gjykimin e dy çështjeve administrative, nr. *** regjistrimi, datë 10.04.2014 dhe nr. *** regjistrimi, datë 16.07.2014. Në përfundim është konstatuar se gjykimi i këtyre çështjeve ka zgjatur respektivisht 9 muaj e 19 ditë dhe 1 vit 3 muaj e 4 ditë. Duke marrë në konsideratë ngarkesën tepër të lartë sasiore të gjyqtarit, kjo ankesë i është regjistruar atij për vlerësim profesional dhe etik;
 - vii. një ankesë e vitit 2015 verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe për zvarritje gjykimi. Pas verifikimit, ankesa është sugjeruar të arkivohet, me arsyetimin se shkeljet nuk vërtetohen;
 - viii. një ankesë e vitit 2015 është verifikuar për zvarritje në gjykimin e çështjes administrative nr. *** regjistrimi, datë 27.02.2014 dhe është konstatuar se gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur 1 vit e 9 muaj. Duke marrë në konsideratë ngarkesën tepër të lartë sasiore të gjyqtarit, për këto parregullsi atij i është tërhequr vëmendja me shkrim;
 - ix. një ankesë e vitit 2015 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe shkelje formale të dispozitave procedurale. Në përfundim është konstatuar zvarritje në gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore (nr. *** regj, datë 06.03.2015; nr. *** regj, datë 27.04.2015; nr. *** regj, datë 27.04.2015; nr. *** regj, datë 13.06.2014; dhe nr. ***regj, datë 18.07.2014) dhe relacioni i është dërguar Ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit;
 - x. një ankesë e vitit 2016 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe për shkelje etike. Nga verifikimi është konstatuar se gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit, 4 muaj e 19 ditë, por te kohëzgjatja ka ndikuar ngarkesa e lartë sasiore e gjyqtarit. Për këtë shkak, është sugjeruar regjistrimi i kësaj ankesë për vlerësim profesional të gjyqtarit. Ndërsa pretendimet për shkeljen e etikës profesionale nuk janë vërtetuar (*është konstatuar vetëm diksion i lartë zëri në komunikimin në seancë*) dhe për këtë shkak, është sugjeruar arkivimi i ankesës për këtë pretendim.

Për periudhën e rivlerësimit, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Ahmet Jangulli rezulton se ministri i Drejtësisë ka paraqitur pranë KLD-së kërkesën me nr. 2360/6 prot., datë 21.10.2014, për procedimin disiplinor të gjyqtarit Ahmet Jangulli, duke kërkuar masën disiplinore "*Vërejtje me paralajmërim*". Ky procedim disiplinor u bazua në verifikimin e një ankesë të kryer nga Inspektorati i KLD-së, ku u konstatua mungesë e arsytimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 28.05.2013, nga gjyqtari Ahmet Jangulli. Përgjatë procedimit disiplinor, KLD-ja me vendimin nr. ***, datë 04.02.2015, urdhëroi Inspektoratin e KLD-së të verifikonte të gjitha vendimet e cenuara të gjyqtarit Ahmet Jangulli për tri vitet e fundit kalendarike, 2012, 2013 dhe 2014. Ky verifikim shtesë u përfundua nga Inspektorati me raportin e datës 18.02.2015, ku u konstatua se gjyqtarit Ahmet Jangulli i ishin cenuar 130 vendime gjyqësore. 96 vendime janë dhënë prej tij në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ndërsa 34 vendime në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Në 20 raste, gjykatat më të larta kishin evidentuar çështje të cilësisë

së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në përfundim, të procedimit disiplinor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 19, datë 03.03.2015, caktoi masën disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim ndaj gjyqtarit Ahmet Jangulli*”. Mbi ankimin e gjyqtarit Ahmet Jangulli, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 29.06.2015, ka shfuqizuar vendimin e KLD-së për caktimin e masës disiplinore. Aktualisht, kjo çështje është për shqyrtim pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në statusin “*Studim i çështjes*”.

1. Vlerësim profesional për subjektin bazuar në kriteret e vlerësimit parashikuar në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka rezultuar:

1) Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në dokumentin ligjor dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes. Subjekti i rivlerësimit ka paqartësi në konceptet procedurale të gjykimit administrativ, ku nuk diferencon veprimet përgatitore që kryhen nga gjyqtari pa pjesëmarrjen e palëve nga seanca përgatitore me pjesëmarrjen e palëve; kthimin e padisë dhe të akteve nga caktimi i afatit për plotësimin e të metave, si dhe rendin e veprimeve përgatitore. Për ilustrim, ai procedon gjithnjë me komunikimin e akteve paditësit dhe më pas, vlerëson që padia ka të meta, që i shkakton atij humbjen e një seance gjyqësore, sepse plotësimi i të metave i njoftohet sërish të paditurit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të ministrit të Drejtësisë, ka dhënë në vitin 2015 ndaj këtij gjyqtari masën disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim*” për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

b) Arsyetimi ligjor

Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej gjyqtarit Ahmet Jangulli përmbajnë strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Arsyetimin e vendimit e strukturon në paragrafë të numërtuar, sipas argumentit që merr në analizë. Fjalitë ndonjëherë paraqiten të gjata, të mbushura me referenca në ligj, ku nuk mungojnë rastet që teksti të jetë i pakuptueshëm.

Struktura e vendimeve të tij është jo gjithmonë e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Edhe nga verifikimi shtesë i kryer nga Inspektorati i KLD-së, përgjatë procedurës disiplinore të gjyqtarit Ahmet Jangulli të vitit 2015, janë konstatuar parregullsi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Ai i kushton rëndësi edhe arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, por në ndonjë rast mungon shkak ligjor.

2) Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (deri më datë 04.11.2013) dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Ai ka deklaruar se tri vitet e fundit të detyrës i janë caktuar për gjykim gjithsej **2114** çështje gjyqësore dhe ka përfunduar si kryesues gjithsej **1392** çështje gjyqësore, duke mbartur vitin e fundit 723 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 65.84 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, për efekte të organizimit të shortit konstatohet se, për periudhën e rivlerësimit,

08.10.2013 - 08.10.2016, gjyqtari Ahmet Jangulli ka gjykuar gjithsej 1270 çështje gjyqësore, nga të cilat 909 administrative dhe 361 marrëdhënie pune.

Në interpretim të pikës 3, germa “c”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet.

Ka rezultuar që në disa raste gjyqtari ka tejkuluar afatet parashikuar nga ligji për gjykimin e çështjes. Shkak për tejkalimin e afateve në këto çështje është bërë njoftimi i palëve, planifikimi i seancave dhe mosorganizimi i punës. Megjithatë, në analizën e kësaj të dhëne duhet mbajtur në konsideratë edhe ngarkesa tepër e lartë sasiore e gjyqtarit.

Kohëzgjatja e gjykimit është analizuar edhe te dokumenti ligjor i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë rast është konstatuar se gjykimi i çështjes ka përfunduar për 3 muaj e 8 ditë, duke tejkuluar afatin standard 1-mujor.

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, për gjyqtarin Ahmet Jangulli, janë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së, ndër të tjera, 8 ankesa për zvarritje gjykimi.

- një ankesë e vitit 2015 është arkivuar pas verifikimit, pasi shkeljet e pretenduara nuk janë provuar;
 - për një ankesë të vitit 2014, gjyqtarit i është tërhequr vëmendja me shkrim;
 - për një ankesë të vitit 2014, gjyqtarit Jangulli, parregullsitë procedurale që kanë ndikuar në zvarritjen e gjykimit, i janë regjistruar për vlerësimin profesional dhe etik;
 - për një ankesë të vitit 2015, ku është konstatuar kohëzgjatja e gjykimit të një çështjeje administrative të vitit 2014 prej 1 vit, 1 muaj e 16 ditë, gjyqtarit i është regjistruar për vlerësim profesional dhe etik, pasi është marrë në konsideratë ngarkesa tepër të lartë sasiore e gjyqtarit;
 - për një ankesë të vitit 2015, kohëzgjatja e gjykimit të dy çështjeve administrative për 9 muaj e 19 ditë dhe 1 vit 3 muaj e 4 ditë, i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik, duke marrë në konsideratë ngarkesën tepër të lartë sasiore të tij;
 - për një ankesë të vitit 2015, kohëzgjatja e gjykimit të një çështjeje administrative të vitit 2014 i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik, duke marrë në konsideratë ngarkesën tepër të lartë sasiore të tij;
 - për një ankesë të vitit 2015, zvarritja e gjykimit të 5 çështjeve gjyqësore është vlerësuar si shkelje disiplinore e gjyqtarit dhe materialet i janë përcjellë Ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor²⁰ (shih të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së).
- ✓ **Në lidhje me ankesën e fundit, bazuar edhe në informacion bërë publik, në lidhje me procedimin disiplinor të subjektit të rivlerësimit nga ana e KLD-së, Komisioni,²¹ kërkoi dhe mori në shqyrtim, praktikën e këtij procedimi disiplinor sipas shkresës nr. *** prot., datë 15.05.2018.**

Ministria e Drejtësisë, në shkresën nr. *** prot., datë 21.02.2018, i ka propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Propozim për marrjen e masës disiplinore ‘Shkarkim nga detyra’, për gjyqtarin Ahmet Jangulli”. Ky propozim është kërkuar pasi Drejtoria e Policisë së Shtetit ka depozituar një ankim pranë KLD-së në lidhje me veprimtarinë e gjyqtarit Ahmet Jangulli, të

²⁰ Deri në datën e hartimit të këtij raporti, Ministri i Drejtësisë nuk ka paraqitur kërkesë për procedimin disiplinor të këtij gjyqtari bazuar në materialet e këtij verifikimi të Inspektoratit të KLD-së.

²¹ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 08.05.2018, drejtuar KLD-së, me të cilën është kërkuar praktika e procedimit disiplinor për subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli.

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për zvarritje gjykimi në 5 çështje civile, të viteve 2014 dhe 2015, ku Drejtoria e Policisë së Shtetit ka qenë palë ndërgjyqëse.

Ministria e Drejtësisë, në shkresën e saj drejtuar KLD-së, me objekt: “*Propozim për marrjen e masës disiplinore për shkarkim nga detyra për gjyqtarin Ahmet Jangulli*”, argumenton sa më poshtë vijon: “Ankuesi, Drejtoria e Policisë së Shtetit, paraqet fakte se gjyqtari Ahmet Jangulli, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, nuk ka respektuar Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin Civil, në lidhje me 5 çështje që ka pasur në shqyrtim ky gjyqtar. Shkeljet e pretenduara nga ankuesi kanë të bëjnë me shkelje procedurale të afateve, si dhe me mospranimin e përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur, Drejtoria e Policisë së Shtetit, duke sjellë si pasojë zvarritjen e gjykimit të çështjeve administrative, të regjistruara në këtë gjykatë.

Ministria e Drejtësisë informon se nga të dhënat e grumbulluara gjatë verifikimit të kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, çmohet se ankesa e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, për zvarritjen e gjykimit të çështjeve objekt kontrolli, nga ana e gjyqtarit Ahmet Jangulli, është e bazuar dhe e drejtë.

Për 5 rastet e denoncuara nga Policia konstatohen zvarritje të procesit, pasi kanë tejkalluar standardin kohor të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Sipas ligjit të mësipërm, në nenet 25, 26, 27, 28, 34 dhe 42, janë caktuar afatet procedurale për kryerjen e veprimeve nga gjykata deri në dhënien e vendimit përfundimtar të arsyetuar. Duke mbledhur këto afate për çdo veprim procedural të gjykatës, kemi një afat përfundimtar prej 92 ditësh, i cili është dhe afati i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit administrativ.

Në rastet e denoncuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit është shkelur parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parashikuar në Kodin e Procedurës Civile në nenin 28 të tij, i cili parashikon se: "*Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashikohen në një padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm, brenda një afati të arsyeshëm*".

Për të gjetur shkaqet që kanë çuar në zvarritjen e gjykimit, u analizuan veprimet procedurale të kryera nga gjykata

Nga verifikimet e kryera, vërehet se gjyqtari pasi ka marrë çështjet²² me short, ka caktuar seancën përgatitore. Pasi ka realizuar seancën e parë përgatitore, i cakton afat palëve për depozitim të prapësimeve me shkrim, duke caktuar një seancë të dytë përgatitore, por në distancë kohore të konsiderueshme. Kështu periudha mes dy seancave paraqitet për çdo rast mjaft e gjatë. Ky është shkaku kryesor që gjykimi tejkallon afatet e përcaktuara të gjykimit.

Ministria e Drejtësisë informon se për sa i përket ankesës se gjyqtari nuk ka legjitimuar përfaqësuesit me autorizim të caktuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, konstatohet se në procesverbalet e seancave gjyqësore, në të pesta rastet e mësipërme, gjykata ka relatuar se: "*I bëjmë me dije përfaqësuesit se tagrat tuaja të përfaqësimit janë me cen*", duke iu drejtuar në këtë mënyrë përfaqësuesve me autorizim të Policisë së Shtetit, dhe duke mos pranuar përfundimisht në gjykim përfaqësuesit e Policisë së Shtetit dhe duke marrë vendimin për gjykimin në mungesë të tij. Ky qëndrim i gjyqtarit nuk është bërë shkak për zvarritje, pasi gjykata e ka konsideruar përfaqësimin *nul* dhe ka vijuar me gjykimin në mungesë, duke

²²Çështjet e shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit dhe për të cilat ka depozituar ankim Drejtoria e Policisë së Shtetit:

1. Çështja me paditës: Shoqëria "****" sh.p.k., periudha mes dy seancave përgatitore, të caktuara nga gjyqtari, është 5 muaj dhe 8 ditë.
2. Çështja me paditës: E. C, periudha mes dy seancave përgatitore, të caktuara nga gjyqtari, është 6 muaj.
3. Çështja me paditës: B. B, periudha mes dy seancave përgatitore, të caktuara nga gjyqtari, është 5 muaj dhe 18 ditë.
4. Çështja me paditës: Gj. D, periudha mes dy seancave përgatitore, të caktuara nga gjyqtari, është 10 muaj.
5. Çështja me paditës: F. B, periudha mes dy seancave përgatitore, të caktuara nga gjyqtari, është rreth 1 vit.

vlerësuar se përfaqësuesi nuk përmbush kushtet ligjore për të qenë përfaqësues, por pa përmendur dispozitën ligjore se ku e mbështet këtë arsyetim, i cili është me pasoja për palën e paditur, Drejtorinë e Policisë së Shtetit, pasi ka të bëjë me zbatimin e parimeve themelore të procesit të rregullt gjyqësor.

Në Kodin e Procedurës Civile, neni 18, parashikohet se: “*Asnjë nga palët nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim*”. Neni 23, përcakton: “*Palët janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi*”. Neni 96 “Pajisja me prokurë e përfaqësuesit”, pika c), përcaktohet: “*Përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë... juristët dhe punonjësit e tjerë të; autorizuar të; institucioneve shtetërore ose të personave juridike*”.

Neni 72 i Kodit Civil, paragrafi i dytë, përcakton: “*Prokura në emër të personave juridikë publikë dhe privatë, mund të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial*”.

Duke qenë se ankesa për këtë çështje është ngritur vetëm pranë Inspektoratit të KLD-së dhe ajo është pjesë e kontrollit gjyqësor nga gjykatat më të lartat, për rrjedhojë kjo pjesë e ankesës rezulton të jetë arkivuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Përfundimisht, Inspektorati i KLD-së, sipas raportit të datës 26.04.2018, si dhe Ministria e Drejtësisë sipas shkresës me nr. *** prot., datë 21.02.2018, kanë konkluduar se ankesa e Drejtorisë së Policisë së Shtetit për zvarritje të proceseve gjyqësore është provuar se është e drejtë. Gjykata ka qenë shkak i zvarritjes së gjykimeve të analizuara më sipër, kurse ankesa lidhur me vlerësimin e autorizimeve të përfaqësimit të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, është arkivuar nga Inspektorati i KLD-së.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në 4 çështje themeli të vëzhguara, ai ka kryer veprimet përgatitore, të cilat janë dokumentuar rregullisht me procesverbal, por efektiviteti i tyre nuk ka qenë në nivelin e duhur.

Gjyqtari i vë në lëvizje çështjet gjyqësore brenda afatit 7-ditor të parashikuar në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012, por në vijim nuk merr masat për kryerjen e veprimeve të duhura dhe sipas afateve, duke pasur mangësi edhe në dokumentimin e tyre.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Dokumentacioni në 5 dosjet e vëzhguara në përgjithësi është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti në shumicën e tyre janë të sakta nga ana formale. Gjyqtari Ahmet Jangulli ndjek praktikën që seancat përgatitore apo gjyqësore i cakton me urdhër apo vendim formal të veçantë, por këto akte përfshihen në dosje të panëshkruara prej tij. Radhitja e akteve në dosje nuk ndjek të njëjtën metodologji. Në 3 raste, dosja nuk është sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale civile, pasi janë administruar më parë diskutimet përfundimtare të palëve e më pas procesverbalet përgatitore e ato gjyqësore, duke e bërë të vështirë shfrytëzimin e dosjes për palët.

3) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtarin Ahmet Jangulli janë verifikuar nga Inspektorati i KLD-së, ndër të tjera, 2 ankesa për shkelje të etikës profesionale (një ankesë e 2014 dhe një ankesë e 2016). Për ankesën e vitit 2014, atij i është tërhequr vëmendja me shkrim për mënyrën e komunikimit me palët ndërgjyqëse, ndërsa në rastin e ankesës së vitit 2016 është konstatuar vetëm komunikim me ton të lartë zëri dhe, për pasojë, ankesa është arkivuar.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, konstatohet se KLD-ja, me propozim të Ministrit të Drejtësisë ka dhënë në vitin 2015 ndaj gjyqtarit Ahmet Jangulli masën disiplinore, “Vërejtje me paralajmërim”, për shkak të mungesës së arsytimit të vendimit gjyqësor. Kjo masë është shfuqizuar nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka dhënë ende vendim mbi rekursin e paraqitur nga KLD-ja (*shih të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së*).

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga dokumenti ligjor i paraqitur nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli. Për vetë gjyqtarin Ahmet Jangulli në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, në asnjë rast nuk është konstatuar të ketë pasur objekt çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në asnjë rast nga dokumenti ligjor dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

KLD-ja në raportin profesional ka argumentuar se në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor, është konstatuar se gjyqtari Ahmet Jangulli komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në të gjitha rastet, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në dokumentin ligjor dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Janë evidentuar raste, që ka pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, por jo dështim të seancave të planifikuara apo vonesa në arsytimin e vendimeve, që të lidhet me nivelin e bashkëpunimit të tij me administratën gjyqësore dhe kolegët.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 5 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (*shih të dhënat tek trajnimet në 3 vitet e fundit*). Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 9 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ të shkallës së parë. Nuk dokumentohet që gjyqtari Ahmet Jangulli të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale, jashtë Shkollës së Magjistraturës, përgjatë periudhës së rivlerësimit.

2. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ, ndër të tjera²³, ka argumentuar se:

²³ Shih në dosjen e subjektit parashtrimet, më datë 24.09.2018, dhe deklaratimet gjatë seancës dëgjimore;

- Konstatimet e KLD-së në lidhje me mosdokumentimin e kalimit nga njëra seancë përgatitore te seanca tjetër përgatitore nuk qëndrojnë sepse nuk ka seanca përgatitore vazhduese dhe se për çdo seancë përgatitore ka vendimmarrje për caktimin e saj në një kohë kur procesverbalet e seancave përgatitore, janë të plota, duke pasqyruar të dhëna dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera;
- Në rastet kur KLD-ja ka konstatuar se seancat gjyqësore nuk kanë qenë produktive apo nuk janë shënuar oraret e seancave, subjekti ka argumentuar se secila nga seancat e çështjeve të evidentuara nga KLD-ja kanë dhënë produktin e saj dhe se seancat kanë qenë planifikuar në orar.
- Mbi konstatimet e KLD-së, që vendimet e ndërmjetme janë të panënshkruara prej tij, subjekti pretendon se vendimmarrjet për caktimin e seancës përgatitore janë krejt korrekte në varësi të veprimit përgatitor që është planifikuar për t'u kryer në seancë përgatitore, të nënshkruara nga gjyqtari me “d. v. ”, që në kompjuter, me një nënshkrim që njihet nga të gjitha shkallët e gjyqësorit, edhe në vendimmarrjet e themelit (*Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë*); dhe vendimmarrjet nuk kanë asnjë lloj pasaktësie në datë (asnjëri prej tyre).
- Në lidhje me konstatimin e KLD-së, se dosja gjyqësore së bashku me vendimin janë depozituar në sekretarinë e gjykatës pas 1 muaji e 1 dite nga shpallja, subjekti e ka kundërshtuar duke argumentuar se dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në sekretari të nesërmen e datës së shpalljes (aty bëhet fjalë për një lapsus të sekretarisë, për më shumë aktet provuese në të cilat janë dhënë sqarimet e sekretarisë). Ky pretendim është shoqëruar dhe me një procesverbal të lëshuar nga kancelaria e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
- Për çështjen gjyqësore, me objekt: “*Lëshim urdhri ekzekutimi*”, gjykimi ka zgjatur 21 ditë, dhe KLD-ja ka konstatuar se kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin 5-ditor të caktuar nga neni 511, germa “ç” e Kodit të Procedurës Civile, subjekti ka pretenduar se gjyqtari nuk e pret dosjen te dera e sekretarisë, por çështja e regjistruar qëndron në pritje të gjykimit dhe seanca është lënë në afatin e mundshëm për të njoftuar palët. Subjekti pretendon se kjo kohëzgjatje është tej afatit 5-ditor të caktuar nga neni 511, germa “ç”, e Kodit të Procedurës Civile; afat ky që konsumohet deri te veprimet e regjistrimit në gjykatë, pa u paraqitur akoma para gjyqtarit (si nga personi që paraqet kërkesën në gjykatë nëpërmjet postës, ashtu edhe nga veprimet e regjistrimit në gjykatë), afat të cilin jo më kot e ka hequr fare ligjvënësi (*në nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile, me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Civile, me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017, është hequr afati 5-ditor*), dhe në një kohë kur çështja e regjistruar qëndron në pritje të gjykimit.
- Në lidhje me konstatimin e KLD-së për këtë çështje se gjyqtari nuk ka marrë masat për menaxhimin e çështjes, për të caktuar seancën gjyqësore brenda afatit 5-ditor të parashikuar në nenin 511 “Urdhri i ekzekutimit” të Kodit të Procedurës Civile, subjekti ka pretenduar se gjykimi është zhvilluar në kohën më minimale të mundshme, pasi gjyqtari nuk e pret dosjen te dera e sekretarisë, çështja e regjistruar qëndron në pritje të gjykimit, seanca është lënë në afatin e mundshëm për të njoftuar palën, dhe seanca për lëshimin e urdhrin nuk është caktuar pas 21 ditëve, pasi urdhri ka dalë, më datë 13.06.2016, duke caktuar seancën për në datën 29.6.2016, në afatin e mundshëm për të njoftuar palën, dhe jo për të lënë një seancë thjesht e vetëm për seancë.
- Për çështjet e konstatuara nga KLD-ja, se janë shqyrtuar duke tejkaluar afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga germa “c” e pikës 5 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, subjekti ka pretenduar se sistemi i vlerësimit është një rregullim ligjor para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, dhe për më tepër që, edhe sipas vetë sistemit, për rastin në gjykim është krejt e kundërta, pasi lënda e gjykimit nuk është lënda administrative që bën fjalë sistemi. Aty bëhet fjalë për çështje shumë komplekse edhe të vetme si padi

(por, veç padisë ka pasur edhe ndërhyrje dytësore), ku në formë bëhet fjalë për disa akte administrative dhe të tjera kërkime për llogari të tyre, ndërsa në themel bëhet fjalë për një konflikt pronësie midis paditësit e ndërhyrësit dytësor; gjë e cila nuk mund të konsiderohet kurrë si lënda administrative që bën fjalë sistemi, por më së paku si një çështje që ka në përbërje disa kërkime. Gjithashtu, të mos harrojmë rrethanën që edhe për lëndën e gjykimit që bën fjalë sistemi, dhe për afatin kohor 1 mujor, këtë afat kohor rregullimi ligjor e lidh me ngarkesën e punës jo më pak se 150 gjykime çështjesh në vit, dhe jo me dhjetëfishin apo më shumë si ngarkesë pune në vit.

Në lidhje me konstatimet e KLD-së, që në një proces gjyqësor subjekti i rivlerësimit në një nga veprimet e para përgatitore, siç është ai i kthimit për plotësim të të metave të padisë, është kryer nga gjyqtari pas 4 muajsh, në shkelje të nenit 25/1 të ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet për afate të shpejta e të arsyeshme, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, subjekti ka pretenduar se padia dhe aktet shoqëruese të saj, i njoftohen palëve pas plotësimit të padisë (çështje vihet në lëvizje pas pritjes së gjykimit) dhe afati 10-ditor nga marrja e njoftimit, lidhet me aftin e depozitimit në sekretari të prapësimeve etj., dhe nuk mund ta konceptojë se përse e ka përdorur këtë konstatim në këtë kontekst.

Në lidhje me konstatimin e KLD-së se nuk është pasqyruar në procesverbal nga gjyqtari, nëse është paraqitur në seancë pala paditëse, subjekti ka argumentuar se procesverbalet e seancës gjyqësore janë mbajtur e mbahen nëpërmjet regjistrimit audio në mënyrë krejt korrekte, konform procedurës civile (neni 118, i Kodit të Procedurës Civile), edhe në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 08.06.2016, është pasqyruar në procesverbal prania ose jo e paditësit (qoftë edhe në përmbledhjen me shkrim, që bëjmë, sikur të ishim pa regjistrim audio).

3. Rivlerësimi profesional i trupit gjykues

Në lidhje me pretendimin e subjektit se nuk qëndron konstatimi i KLD-së mbi mosdokumentimin e kalimit nga njëra seancë përgatitore tek seanca tjetër përgatitore, sepse nuk ka seanca përgatitore vazhduese, Komisioni, argumenton se në këtë rast, nuk bëhet fjalë për seanca përgatitore vazhduese, por për konstatimet nga KLD-ja në dosjet e shqyrtuara, nga ku ka rezultuar se gjyqtari nuk ka pasqyruar veprimet sipas nenit 158/a, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“Gjyqtari cakton, për çdo çështje, seancën përgatitore, ku thirren palët ose personi i tretë, për të përcaktuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe kërkon prej tyre shpjegimet e nevojshme, si dhe përcaktimin e provave për vërtetimin e pretendimeve e të prapësimeve të tyre. Gjyqtari, me vendim, kryen veprime...”*. Duke mos kryer veprimet procedurale të parashikuara për seancën përgatitore, këto janë kryer në seancat vijuese, duke kryer disa seanca në të cilat janë kryer veprimet përgatitore dhe për pasojë seancat kanë qenë joproduktive.

Komisioni konstaton se në rastet e evidentuara nga KLD-ja, veprimet procedurale nuk kanë qenë produktive apo nuk janë përshkruar sipas parashikime ligjore. Dhe nëse seancat kanë dhënë produktin e vet, nuk janë dokumentuar siç duhet në procesverbal nga gjyqtari.

Lidhur me pretendimin e subjektit se vendimmarrjet për caktimin e seancës përgatitore janë krejt korrekte në varësi të veprimit përgatitor që është planifikuar për t’u kryer në seancë përgatitore, të nënshkruara nga gjyqtari me “d. v.” që në kompjuter, me një nënshkrim që njihet nga të gjitha shkallët e gjyqësorit, Komisioni vlerëson se këto akte nuk janë mbajtur në përputhje me nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës, dhe përfshihet në dosjen gjyqësore...”*.

Në lidhje me konstatimin e KLD-së për këtë çështje, se gjyqtari nuk ka marrë masat për menaxhimin e çështjes, për të caktuar seancën gjyqësore brenda afatit 5-ditor të parashikuar në

nenin 511 “Urdhri i ekzekutimit” të Kodit të Procedurës Civile, e pretendimin e subjektit se gjykimi është zhvilluar në kohën më minimale të mundshme, çështja e regjistruar qëndron në pritje të gjykimit, seanca është lënë në aftin e mundshëm për të njoftuar palën, Komisioni, vëren se në kohën kur është shqyrtuar kjo çështje nga subjekti i rivlerësimit, në nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile, ishte parashikuar se: *“Titulli ekzekutiv vihej në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili: ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, lëshohet nga gjykata e vendit ku detyrimet që përmban titulli ekzekutiv do të përmbushen, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit”*. Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka vepruar në respektim të afateve ligjore, pasi legjislatori jo pa shkak ka vendosur një afat të shkurtër për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, pasi vonesat e ekzekutimit të tij mund të sjellin pasoja negative tek pala kërkuese.

Në lidhje me pretendimin e subjektit²⁴, se çështjet e shqyrtuara nga e tij nuk kanë tejkaluar afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga germa “c” e pikës 5 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, dhe se “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, është një rregullim ligjor para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, Komisioni gjykon se “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” synon krijimin e standardeve orientuese dhe, në vlerësimin e kryer për gjetjen e pozicionit të subjektit në tejkallim të afateve thelbësore, është marrë në konsideratë shqyrtimi i veprimeve konkrete zvarritëse që ka kryer gjyqtari, për pasojë janë çmuar si problematika. Në këtë drejtim, gjithashtu është marrë në konsideratë fakti se vonesa në shqyrtimin e çështjeve, duke tejkaluar afatin 1- mujor të parashikuar, kanë rezultuar në pjesën më të madhe të dosjeve të shqyrtuara nga subjekti, çka tregon se është një praktikë pune e tillë e tij.

Në lidhje me pretendimet e subjektit për ngarkesën e madhe në punë, Komisioni konstaton se është e vërtetë që subjekti ka pasur ngarkesë të madhe në numrin e dosjeve të shqyrtuara dhe kjo mund të jetë bërë shkak për vonesa, por KLD-ja, për analogji ka referuar se gjyqtarë të tjerë me të njëjtën ngarkesë pune i kanë menaxhuar më mirë dosjet e shqyrtuara, duke mos shkaktuar shkelje afatesh si në rastin e subjektit Ahmet Jangulli.

Komisioni konstaton se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë dhe nuk mund të merren në konsideratë sepse në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht se: *“1. Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime: a) I kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë”*.

Trupi gjykues, gjatë vlerësimit profesional të këtij subjekti ka konstatuar se, bazuar në kriteret e vlerësimit profesional të ligjit nr. 76/2016, për subjektin e rivlerësimit **rezultojnë të dhëna që e identifikojnë atë me të meta apo probleme në gjykimin e rasteve, sipas neneve 72 - 76 të ligjit nr. 76/2016, të tilla si:**

- ✓ mosrespektim i afateve ligjore, fjalitë nëpër vendime me paraqitje të gjata, të mbushura me referenca në ligj, ku nuk mungojnë rastet që teksti të jetë i pakuptueshëm;
- ✓ janë konstatuar paqartësi në konceptet procedurale të gjykimit administrativ, ku nuk diferencohen veprimet përgatitore që kryhen nga gjyqtari pa pjesëmarrjen e palëve nga seanca përgatitore me pjesëmarrjen e palëve;
- ✓ janë konstatuar zvarritje në gjykim, duke theksuar rastin e shqyrtimit të çështjes gjyqësore nr. *** regj., datë 14.01.2014, për 6 muaj dhe në përfundim është shpallur moskompetenca;
- ✓ kanë rezultuar të dhëna për çështje pa veprim, për rreth 1 vit;
- ✓ janë konstatuar parregullsi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore;

²⁴ Sipas konstatimit të IKLD-së në raportin profesional.

- ✓ rezultuan të dhëna nga regjistri i ankesave nga ku gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, janë paraqitur gjithsej 16 ankesa në Inspektoratin e KLD-së;
- ✓ kanë rezultuar ankesa edhe me objekt :“Shkelje të etikës”, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 - raste të shkeljes së rregullave të etikës u denoncuan edhe përmes denoncimeve të publikut;
- ✓ rezultuan të dhëna për aplikim të masave disiplinore gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”.
- ✓ lidhur me aftësitë e komunikimit, trupit gjykues i rezultoi se subjekti demonstroi aftësi të papranueshme në komunikim, sipas parashikimeve të nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Në vlerësimin e problematikave të evidentuara sa më sipër, trupi gjykues ka pasur në konsideratë faktin se problematikat janë konstatuar në një numër relativisht të ulët (*vetëm 6 çështje*), në raport me çështjet e trajtuara²⁵ nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke nënvizuar faktet si më poshtë:

- në 6 dosjet e shqyrtuara nga KLD-ja janë konstatuar shumë mangësi procedurale, të cilat përsëriten në kohë;
- problemet janë konstatuar edhe në një nga dosjet e përzgjedhura nga vetë subjekti;
- përzgjedhjen e gabuar të subjektit për çështjet që nuk përmbushnin kriterin e “dokumentit ligjor” të parashikuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 84/2016;
- zvarritje të procesit, për të pesta rastet e denoncuar nga Policia e Shtetit në tejkallim të standardin kohor të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", dhe shkelje të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm²⁶, sipas nenit 28 të Kodit të Procedurës Civile;
- shkelje të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor,²⁷ në pesë çështjet e denoncuar nga Policia e Shtetit, duke zhvilluar proces pa palë²⁸, dhe duke mos përmendur dispozitën ligjore se ku mbështet në arsyetim.

- janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka njohuri, aftësi, gjykim apo sjellje të cekët, një mënyrë /praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij dhe çmon se mangësitë e vërejtura nuk mund të korrigjohen përmes programit.

Për sa më sipër, bazuar në :

- Nenin E, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “*Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të*

²⁵ Ngarkesa e punës nuk mund të justifikojë vonesat në gjykimet e mësipërme, pasi kjo ngarkesë është edhe për gjyqtarët e tjerë të cilët nëpërmjet një administrimi të mirë të çështjeve kanë arritur të realizojnë gjykimin e tyre brenda afateve të arsyeshme.

²⁶Standardi i procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

²⁷ Neni 2/3/a i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (adheruar me ligjin nr. 7510, datë 08.08.1991), neni 14/3/ç . E drejta për një proces të drejtë gjyqësor.

-Udhëzues për implementimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut/Këshilli i Evropës F-67075, Strasbourg Cedex)

-Çfarë përgjegjësie kanë gjyqtarët?

Gjyqtari ka përgjegjësinë që të sigurojë që të mbështetet parimi i barazisë në mjete, që do të thotë se të gjitha palëve duhet t’u jepet një mundësi e drejtë për të prezantuar çështjen e tyre në kushte të tilla që të mos vihen në një disavantazh të konsiderueshëm përballë kundërshtarëve të tyre. Në çështjen e “Krcmar” dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, gjykata deklaroi se: “Një palë në procesin gjyqësor duhet të ketë mundësinë për tu njohur me provat e paraqitura gjykatës, si dhe me mundësinë për të komentuar mbi ekzistencën e tyre, përmbajtjen dhe vërtetësinë në mënyrën e duhur dhe brenda një kohe të përshtatshme, e nëse nevojitet, me shkrim e më përpara”.

- Çfarë përfshin nocioni i një “procesi të drejtë”? Neni 6 deklaron se çdokush ka të drejtën e një seance të drejtë gjyqësore. Kjo shprehje përfshin shumë aspekte të procesit të duhur të së drejtës, si e drejta për akses në gjykatë, për një seancë në prezencën e të akuzuarit, e drejta për të mos kontribuar në vetë-inkriminim, barazia në mjete, e drejta për seanca gjyqësore me palë kundërshtuese dhe një gjykim i arsyeshëm. Detyra e gjyqtarit është të sigurojë që të gjitha palët në një mosmarrëveshje të kenë një “seancë të drejtë gjyqësore” për të cilën Konventa i jep këtë të drejtë

-Barazia në mjete dhe e drejta për t’u vënë në dijeni për faktet e argumentet e palës kundërshtare dhe anasjelltas

E drejta për një seancë të drejtë përfshin parimin e barazisë së mjeteve. Kjo nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabartë që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit.

Duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve. E drejta për një seancë të drejtë përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët në një seancë civile apo penale që të kenë njohuri edhe mbi komentet mbi provat e nxjerra ose hetimet e arkivuara .Në këtë kontekst një rëndësi e veçantë duhet ti jepet shfaqjes së ushtrimit të drejtë të drejtësisë

²⁸Në Kodin e Procedurës Civile, neni 18, parashikohet se: “*Asnjë nga palët nuk mund të gjykohej pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim*”. Neni 23, përcakton: “*Palët janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi*”.

- kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”;*
- Nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *“Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale”;*
 - Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: *“... Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias); -*
 - Nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit”.*

- **për kriterin e vlerësimit etiko - profesional**, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, trupi gjykues **konkludon** se subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, nuk arrin një nivel minimal kualifikues profesional. Për pasojë, në zbatim të nenit 61, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, rezulton **“i papërshtatshëm”** nga vlerësimi i aftësive profesionale.

DENONCIME NGA PUBLIKU SIPAS NENIT 53 TË LIGJIT NR. 84/2016

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u paraqitën denoncimet, nr. 6069, datë 12.09.2018, me objekt: *“Shkelje etiko - profesionale e zvarritje në proces”*, bashkëlidhur audio e seancës, si dhe denoncimi, nr. 5892, datë 06.09.2018, me objekt: *“Aftësi profesionale”*. Në lidhje me denoncimin nr. 1 i cili është shoqëruar dhe me një CD- audio, ku është dhënë regjistrimi i seancës gjyqësore, gjyqtari në pretendimet e tij të datës 24.09.2018, ndër të tjera ka argumentuar se: *“Nisur nga vendimmarrja përkatëse, dhe në ato çfarë më kujtohen për momentin, në seancë, paditësi jo vetëm që nuk parashtrroi kërkimet e kërkesat për prova, për llogari të padisë së ngritur, por gjatë prapësimeve të palës së paditur tentoi që të bllokojë seancën, duke prishur rregullin e qetësinë e zhvillimit të seancës gjyqësore (...), dhe për këtë arsye me sa kujtoj seanca është ndërprerë për pak çaste deri sa është realizuar largimi i tij nga seanca, ku më pas gjykimi qenka zhvilluar normalisht. Përballë veprime krejt jo ligjore të palëve, të cilët mund të vijnë në seancë edhe vetëm për këto lloj punësh”.*

Arsyetimi i Komisionit

Lidhur me denoncimet e paraqitura, Komisioni konstatoi se ato ishin të lidhura kryesisht me shkelje të etikës së subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, gjatë gjykimeve të çështjeve. Në CD- audio të denoncimit, Komisioni konstatoi se fjalori i përdorur nga ana e subjektit është në shkelje të etikës së magjistratit.

Komisioni vlerëson se magjistratët, në ushtrimin e funksionit të tyre, duhet të veprojnë në përputhje me respektimin dhe zbatimin e standardeve të larta të sjelljes dhe duhet të ruajnë një pozicion që e bën të mundur pavarësinë, paanësinë dhe drejtësinë e tyre si gjyqtar. Ruajtja e një sjelljeje etike gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit ndihmon në arritjen e këtyre qëllimeve dhe për të përmbushur standarde të tilla të sjelljes së gjyqtarëve në realizimin e funksioneve të shtetit të së drejtës. Në lidhje me rregullat e përgjithshme mbi të cilat duhet të udhëhiqet puna e një gjyqtari, në nenin 4 të Kodit Etik të Gjyqtarëve është parashikuar se: *“Gjatë punës së tij gjyqtari duhet të shmangë çdo sjellje të papërshtatshme dhe që bie në kundërshtim me ligjin, kodin e etikës, si edhe veprime që mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij”.*

Në përfundim, trupi gjykues çmon se komunikimi i subjektit konstatuar në CD-në e denoncuesit, e identifikon atë si një magjistrat me sjellje të papërshtatshme që dëmton figurën e tij.

IV. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Komisioni arrin në përfundimin se:

- a- Subjekti i rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- b- Lidhur me kriterin e rivlerësimit profesional çmon se mangësitë e vërejtura në mënyrë të përsëritur te subjekti nuk mund të korrigjohen përmes programit, dhe e identifikojnë një mënyrë /praktikë pune të papajtueshëm me pozicionin e tij, për pasojë rezulton “*i papërshtatshëm*”, referuar nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Në vlerësimin tërësor të tri kriterëve, në kuptim të nenit 4, pika 2, trupi gjykues, duke analizuar konstatimet mbi:

- kriterin e pasurisë, sikurse janë deklarame kontradiktore dhe veprimet fiktive, mbi të ardhurat nga fitimi i aktivitetit të bashkëshortes, deklaramet e likuiditeteve *cash*, pranë ILDKPI-së, vlerësohet se ato janë në atë nivel, që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara nga të cilat kanë ardhur pasuri të paligjshme financiare për subjektin e rivlerësimit;
- kriterin e figurës, duke analizuar raportin e DSIKI-së, si dhe materiale të tjera nga institucionet ligjzbatuese dhe konstatimet e Komisionit gjatë hetimit, mbi dosjen gjyqësore të subjektit të arsyetuara më lart në vendim, të krijojnë dyshime mbi pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit;
- kriterin për vlerësimin profesional duke analizuar raportin e institucionit përgjegjës IKLD-së, si dhe praktikën e procedimit disiplinor të arsyetuara më lart në vendim;
- si dhe denoncimet e publikut.

- arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe të pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ahmet Jangulli, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 05.10.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Valbona Sanxhaktari
Kryesues

Brunilda Bekteshi
Relatore

Suela Zhegu
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka